



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 831 Prot.

Tiranë, më 30.01. 2020

URDHËR

Nr. 34, datë 30.01. 2020

PËR  
MOSPËRDORIMIN E MJEDISEVE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË  
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE DHE  
VEPRIMTARIVE NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 të ligjit nr.69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mospërdorimin e mjediseve të institucioneve publike të arsimit parauniversitar për zhvillimin e aktiviteteve, panireve, konkurseve të bursave të studimit nga institucionet arsimore private të arsimit parauniversitar.
2. Veprimtaritë me nxënësit, të kërkuara nga institucionet private të arsimit parauniversitar, të koordinohen nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe të zhvillohen, pas përfundimit të procesit mësimor, në mjedise jashtë institucioneve të arsimit parauniversitar, sipas një kalendari të caktuar.
3. Ngarkohen për zbatimin e Urdhrit, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore Arsimore.

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

MINISTRI  
BESA SHAHINI



